REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5225/17 Prot. Sarandë, më 03.07.2026

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :30.06.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Zv/Kryetar Florjan Sali dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Bejdo Çela
3. Ermir Hoxha
4. Ilirjan Gërdhuqi
5. Dritan Peçi
6. Laureta Çeçi
7. Denisa Islamaj
8. Kevin Alikaj
9. Vesel Koçiu
10. Dafina Allkushi
11. Shpëtim Ahmeti
12. Përparim Ahmeti
13. Klejdjan Murtaj
14. Ibrahim Bajrami
15. Anjeza Dike
16. Gjergji Imeraj
17. Edlira Gjidede

Mungojnë :

18. Zana Piro
19. Angjele Lapa
20. Ilva Qëndro
21. Pranvera Osmani
22. Enea Vasili
23. Indi Rrapaj
24. Xhino Jaçaj
25. Festim Mina
26. Katerina Beqo
27. Thanas Gurma
28. Eugen Qëndro
29. Elona Mano
30. Farie Hyska
31. Lindita Kondi

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 30.06.2026, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim**"Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Maj 2026".
2. **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Maj 2026".
3. **P/vendim** "Për miratimin e shtetasit K. Z për t'u trajtuar në qendrën polivalente ditore të të moshuarve "Feti Rugji" Sarandë ".
4. **P/vendim** "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 faza I".
5. **P/vendim** "Për miratimin e vendndodhjes së terminalit të transportit publik për Bashkinë Sarandë, rregullores së funksionimit dhe tarifave të operimit"
6. **P/vendim**"Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.41,datë 01.06.2026 "Për miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridet e lëvizjes së tyre për Bashkinë Sarandë dhe njësinë administrative Ksamil".
7. **P/vendim** "Për korrigjimin e gabimeve materiale".
8. Raport i monitorimit të Buxhetit për periudhën janar -prill 2026.

Asaf Stroka: Në Këshillin Bashkiak është depozituar Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, Nr. 89-2026-1117, datë 28.05.2026.

Sipas këtij vendimi, gjykata ka vendosur:

- pranimin e padisë së znj. Edlira Gjidede;
- konstatimin e paligjshmërisë së Vendimit nr. 32, datë 28.03.2025, të Këshillit Bashkiak Sarandë, për deklarimin e mbarimit para afatit të mandatit të saj;detyrimin e Këshillit Bashkiak Sarandë për rikthimin e mandatit të znj. Edlira Gjidede si anëtare e Këshillit Bashkiak;
- dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Për rrjedhojë, në zbatim të vendimit gjyqësor Nr.89-2026-1117,datë 28.05.2026.,znj.Edlira Gjidede ftohet të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dhe të ushtrojë mandatin e saj si anëtare e Këshillit Bashkiak me të gjitha të drejtat që burojnë nga mandati i saj.

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës

Miratohet me 17 vota pro rendi i ditës .

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin maj 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin maj 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e shtetasit K. Z për t'u trajtuar në qendrën polivalente ditore të të moshuarve "Feti Rugji" Sarandë ".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 faza I".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Edlira Gjidede: Sa është niveli i realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve deri tani dhe cilat zëra buxhetor janë realizuar në nivel më të ulët dhe vërtetë.

Teuta Stroka: Prioritet e investimeve dhe përqindjen më të madhe të inestimeve të parashikuara janë, në rrugë, arsim.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e vendndodhjes së terminalit të transportit publik për Bashkinë Sarandë, rregullores së funksionimit dhe tarifave të operimit"

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Dritan Peçi : Dua të di nga administrata si është menduar hyrja dhe dalja e autobuzave, ose nëse ka një projekt si do të funksionoj hyrja dalja e automjeteve dhe kur do të fillojnë linjat e Tiranës dhe gjithë linjat e tjera .

Joli Dine : Në lidhje me këtë problem nga ana jonë është kryer një provë, një test në lidhje me hyrje daljet e autobuzave dhe ka rezultuar i suksesshëm. Gjatë projetimit të terminalit nga specialistët përkatës ka pasur studim për këtë gjë.

Klejdjan Murtaj : Unë kam dy pyetje lidhur me këtë projketvendim , A është marrë certifikimi nga ministria apo drejtoria përkatëse , a janë informuar të gjithë operatorët e udhëtimit, si do të funksionoj orari dhe gjithçka tjetër.

Garufo Koka : Edhe pse nuk janë objekt i këtij projektvendimi , të gjitha këto kërkesa do jenë pjesë e masave të mara për të vendosur në funksion këtë aset të rëndësishëm për territorin e Bashkisë Sarandë.Detajet në lidhje me hyrje daljet dhe oraret janë pjesë e rregullores.Vlen të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA SARANDË

përmendet se është zhvilluar një takim me grupin e interesit dhe operatorët e transportit. Kemi dëgjuar sugjerimet e tyre dhe jemi përpjekur ti pasqyrojme në këtë material që ju sot keni përpara.
Laureta Çeçi: a është menduar vendosja e një linje urbane nga terminali në qendrën e qytetit.

Garufo Koka : Po, e kemi thënë dhe herë tjetër , kemi një linjë ekzistuese që përballon lëvizjet nga varrezat tek fshati Çukë, është mdnuar të vendoset një linjë e re vetëm për terminalin, por që të kemi një linjë të re ka disa hapa procedurjale , zhvillimin e konkursit për ta marrë operatori . Për momnetin kemi këtë zgjidhje provizore .

Vesel Koçiu: A ka çertifikatë sigurie për hyrje daljet e automjeteve .

Shpëtim Ahmeti: Ne sot miratojmë transferimin e operatorëve transportues në terminal. Saranda e kishte të domosdoshme një terminal. Të disiplinosh transportin publik është një gjë shumë e rëndësishme, duke pasur parasysh dhe trafikun në Sarandë. Për mua ky terminal është i domosdoshëm. Ne si komision i japim votën por me kusht ti japim fund informalitetit, ku në qytetin tonë ka taksi që punojnë pa taksimetër dhe administrata të sjelli dokumentacionin e nevojshëm.

Kevin Alikaj : Duhet ti tregohet rëndësi sinjalistikës

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.41,datë 01.06.2026 "Për miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridet e lëvizjes së tyre për Bashkinë Sarandë dhe njësinë administrative Ksamil".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Përparim Ahmetaj: Duke njohur mirë terenin në Ksamil, propozoj vendosjen e një moli pluskues shtesë midis vendbazimit me nr147 dhe nr.148,mendoj se duhet lënë një pluskus emergjente, pasi hapësira ndërmjet moleve ekzistuese është e madhe dhe krijon nevojën për një pikë shtesë.Vendosja e këtij moli është e domosdoshme për shfrytëzimin më efikas të zonës.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin me propozimin e bërë nga z.Ahmetaj .

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:**P/vendim** "Për korrigjimin e gabimeve materiale".

Asaf Stroka:Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimet një nga një .
Miratohen me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar, e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 6(gjashtë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj